



PROTOKOLL

ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Krijimin e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënshkruar më 10 qershor 2021 në Tiranë në Pikën Ndërkombëtare të Kalimit Kufitar Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë) – Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut)

Në përputhje me nenin 16 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Krijimin e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar, nënshkruar më 10 qershor 2021 në Tiranë (më tej referuar si Marrëveshja) në Pikën e Kalimit Kufitar ndërkombëtar Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë) – Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut), Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Republika e Shqipërisë dhe Ministria e Financave – Administrata Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe (në vijim referuar si Palët) kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Dispozitat Hyrëse

Ky Protokoll përcakton objektet dhe infrastrukturën për krijimin e kushteve për vendosjen e një Kalimi të Përbashkët Kufitar në Pikën e Kalimit Kufitar Ndërkombëtar Qafë-Thanë (Republika e Shqipërisë)– Kjafasan (Republika e Maqedonisë së Veriut).

Kuptimi i termave të përdorur në këtë Protokoll është përcaktuar në Nenin 2 të Marrëveshjes.

Neni 2

Dispozita të Përgjithshme

Sigurimi i objekteve kryhet në përputhje me Nenin 11 të Marrëveshjes.

Neni 3

Objektet dhe Infrastruktura

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Republikës së Shqipërisë, e cila administron Pikën Kufitare Qafë-Thanë, do të sigurojë kushtet e nevojshme infrastrukturore në territorin e Republikës së Shqipërisë në PKK-në Qafë-Thanë për nevojat e punës së zyrtarëve të Shtetit Fqinj.

Administrata Doganore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila administron Pikën Kufitare Kjafasan, do të sigurojë kushtet e nevojshme infrastrukturore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në PKK-në Kjafasan për nevojat e zyrtarëve të Shtetit Fqinj.

Neni 4

Mirëmbajtja e objekteve dhe infrastrukturës dhe kostot e shërbimeve

Mirëmbajtja e objekteve dhe infrastrukturës, si dhe uji dhe energjia elektrike e konsumuar kryhet nga Shteti Pritës në territorin e tij.

Neni 5

Dokumentacioni teknik

Vizatimet e objekteve që do të ofrohen nga secila Palë janë dhënë si Shtojcë e këtij Protokollit dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 6

Zgjidhja e mos-marrëveshjeve

Në rast mos-marrëveshjeje mbi interpretimin ose zbatimin e këtij Protokollit, Palët së pari do të kërkojnë të zgjidhin reciprokisht mos-marrëveshjen.

Nëse zgjidhja e ndërsjellë e mos-marrëveshjes nuk është e mundur, Palët do të informojnë përfaqësuesit e tyre në Komisionin e Përbashkët.

Neni 7

Vlefshmëria e Protokollit

Ky Protokoll nënshkruhet për një periudhë të pacaktuar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Protokollit mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqimin me shkrim dhe të ndërsjellë të të dyja Palëve, dhe ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.

Protokollit pushon së qeni i vlefshëm në të njëjtën kohë me datën e përfundimit të Marrëveshjes, përveç se kur njëra nga Palët kërkon që Protokollit të përfundojë më herët.

Në këtë rast, Protokollit pushon së qenuri në fuqi në datën e marrjes së njoftimit me shkrim me të cilin njëra nga Palët njofton tjetrën për përfundimin e Protokollit.

Hartuar në Qafë Thue më 27.07. 2023, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, maqedonase dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të divergjencave në interpretim të Protokollit, teksti në gjuhën angleze do të mbizotëroj.

Për
Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Administrata Doganore

Drejtore i Përgjithshëm
Genti Gazheli

Për
Republikën e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Financave
Administrata Doganore

Drejtore i Përgjithshëm në Detyrë
Stefan Bogoev